



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.25/2018

Prishtinë, më 4 korrik 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviq, Mirjeta Kalludra, Saranda Bogujevci, Luljeta Veselaj-Gutaj, Mexhide Mjaku-Topalli, Shemsi Syla, Fisnik Ismaili dhe Teuta Haxhiu

Mungoi: Albulena Balaj- Halimaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Fatime Grajçevci, Januz Grajçevci, Ragip Grajçevci, Adnan Preniqi, Salih Grajçevci, Shaban Preniqi – përfaqësues të fshatit Hade, Valdrin Lluka-ministër MZHE, Hilmi Jashari- Avokat i Popullit, Majlinda Sinani-Lulaj-IAP, Blerina Krasniqi-KDI, Valbona Puka-IAP dhe Mustaf Grainca zëvendësministër i Financave.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë.

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara;
2. Diskutim në komision lidhur me vendimin e qeverisë për themelimin e grupit teknik me qëllim të propozimit të zhvillimit të Minierës së Re të Korporatës Energjetike të Kosovës. Të ftuar: Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, Albena Reshitaj, ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Bedri Hamza, ministër i Financave, Hilmi Jashari-Avokat i Popullit dhe përfaqësuesit e fshatit Hade.

3. Njoftim i Komisionit FunkSIONAL lidhur me shqyrtimin e Peticioneve nga Grupi Punues;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara

Procesverbalet, e mbledhjeve të dt. 2 maj, 10 maj, 25 maj dhe 6 qershor 2018, u miratuan pa vërejtje.

2. Diskutim në komision lidhur me vendimin e qeverisë për themelimin e grupit teknik me qëllim të propozimit të zhvillimit të Minierës së Re të Korporatës Energjetike të Kosovës. Të ftuar: Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, Albena Reshitaj- ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Bedri Hamza, ministër i Financave, Hilmi Jashari, Avokat i Popullit dhe përfaqësuesit e fshatit Hade.

Kryetarja tha se për këtë pikë të rendit të ditës kemi ftuar ministrat kompetent, Avokatin e Popullit, si dhe përfaqësuesit e fshatit Hade.

Ndërsa në vazhdim ia dha fjalën Avokatit të Popullit.

Hilmi Jashari: Ne vazhdojmë me pranuar ankesa nga banoret e fshatit Hade dhe Shipitullë që kanë të bëjnë në rend të parë për të drejtën në kompensim në rastin e shpronësimit. Kemi disa vendime formale që janë marrë nga viti 2004, pastaj në vitin 2009 është miratuar një strategji për zhvendosjen e banorëve të Hades, por megjithatë të drejtat e këtyre banorëve nuk kanë pësuar asnjë ndryshim dhe ballafaqohen me një pasiguri të madhe juridike dhe nuk kanë ndonjë dokument konkret i cili përcakton saktë cilat janë të drejtat dhe detyrimet e këtyre banorëve. Është edhe një vendim i fundit që kontestohet dukshëm nga ana e këtyre banorëve që ka të bëjë me planifikimin e zhvendosjes së mihjes sipërfaqësore në këtë vend. Kjo vonesë nga viti 2004 deri më tani ka ngritur dukshëm edhe koston financiare për të kompensuar shpronësimin e pronave. Këtë banorët e dinë më mirë, por fillimisht është vlerësuar 3 apo 4 milionë euro tash ka arritur përafërsisht në 32 milionë euro dhe nëse vazhdohet kështu do të dëmtohet interesi i vendit.

Valdrin Lluka: Në shtator të vitit të kaluar ishim para një kolapsi energjetik deri sa arritëm një marrëveshje me banorët e fshatit Shipitullë. Projekti i ndërtimit të Kosovës së Re parasheh që ta kemi një minierë për të siguruar furnizimin me thëngjill për 40 vitet e ardhshme dhe

normalisht duhet të vendoset se cila do të jetë kahja e kësaj miniere dhe si rezultat KEK ka angazhuar një kompani konsulente gjermane profesionale, e cila ka bërë një analizë dhe ka dhënë 3 opsione: Është veriu me Hade, veriu pa Hade dhe është pjesa e jugut që është pronësi e KEK-ut. Kompania konsulente ka dhënë të gjitha anët pozitive dhe negative për secilin drejtim, nëse shkohet nga Hadja, kostoja do të jetë më e lartë e thëngjilli më i shtrenjtë dhe e ngrit çmimin e energjisë elektrike. Nëse shkohet nga jugu kostoja e shpenzimeve është më e ulët sepse 96% është tokë publike dhe nuk ka nevojë për shpronësime, kostoja e thëngjillit është më e ulët dhe edhe kostoja e energjisë eklektike. Por cili opsion të merret duhet të merret për bazë edhe impakti social ambientalist i banorëve të asaj zone. KEK-u nuk ishte në gjendje të vendoste se nga të bëhet mihja dhe për këtë arsye vendosem të bëjmë një grup profesional

me ekspertë nga KEK-u, nga Ministria e Ambientit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e deri te shoqëria civile në mënyrë që ta përcaktojmë drejtimin final se nga do të shkojë të japim propozimin për Qeverinë e Kosovës. Në kohë afatgjate Hadja nuk e ka vendin aty, sepse është e rrethuar me thëngjill dhe nuk është e shëndetshme për të jetuar aty.

Mustafë Grainca, zëvendësministër i Ministrisë së Financave, tha se jemi në pritje të një vendimi të drejtë për këtë çështje dhe konform atij vendimi, si ministri e Financave do të veprojmë për të qenë në funksion të një zgjidhje adekuate e cila do të jetë e pranuar për interesin e përgjithshëm shtetëror por edhe të qytetarëve.

Ragip Grajçevci, përfaqësues i fshatit Hade, tha se në fshatin Hade janë shkelur të drejtat e njeriut sepse ne banorët jemi të parët që prekemi nga shëndeti, me humbje të pronave, por pyetemi të fundit dhe nuk na konsulton askush. Kam një porosi për kryeministrin dhe ministrat, se kinse është bërë zgjidhje për Hade dhe Shipitullë, ju lutem të ndahen termat sepse për Haden nuk është bërë zgjidhje. Kërkojmë të nxirret një vendim i drejtë njëherë e përgjithmonë, mos të vijmë në vazhdimësi të mbajmë takime për formalitet, por të dihet se çka po bëhet me këta banorë. Neve nuk na intereson se ka do të zhvillohet miniera, mos i jepni kaheje të kundërt miniera është në Hade, ata banorë duhet të zhvendosen më së largu deri në vitin 2020 sepse janë në gjendje të mjerueshme.

Fatime Graiçevci, përfaqësuese e fshatit Hade, tha se kemi pasur shumë takime lidhur me çështjen e Hades, nga viti 2004 nuk kemi bërë asnjë pengesë dhe kemi përkrahur çdo shpronësim dhe çdo vendim, mirëpo është duke u bërë trajtim çnjerëzor dhe jo human ndaj këtyre banorëve. Po ballafaqohemi me probleme të ndryshme si në arsim, me klasë të përziera, fëmijët tanë zgjohen dhe luajnë në atë ambient të kontaminuar dhe me zhurmë të madhe të makinerive të rënda të KEK-ut. Komuna as një investim më të vogël nuk e ka bërë për arsye se është shpallur zonë e Interesit të veçantë, ndërsa qeveria ndalon çdo ndërtim ku pamundësohet

edhe rritja e familjes. Kërkoj nga qeveria një trajtim dinjitar dhe human të këtyre banoreve dhe të atyre fëmijëve sepse edhe ata kanë të drejtë në jetesë, shkollim dhe ambient të pastër.

Duda Balje tha se ka qenë në Hade dhe kemi parë vërtet se nuk janë kushtet normale për të jetuar. Ajo bëri pyetje për ministrin Lluka, se grupin që ka caktuar qeveria a është konsultuar me përfaqësuesit e fshatit Hade, dhe a kemi mundësi me i plotësuar kërkesat e banorëve të fshatit Hade, së paku në minimum?

Luljeta Veselaj-Gutaj tha se për këtë çështje është diskutuar gjatë nëpër institucionet tona dhe po vazhdon, por ende nuk kemi një zgjidhje për banorët e kësaj zone. Ajo u interesua të dijë se a ka pasur takim grupi i eksperteve me banorët e Hadës dhe Shipitullës, dhe kudo që vendoset miniera është mirë të merren për bazë interesat e qytetarëve.

Teuta Haxhiu u tha se në fillim kostoja financiare ka qenë 3-4 milionë dhe tani është 31 milionë, kjo a është bërë se është shtuar numri i banorëve aq shumë apo pse kjo shifër aq e madhe. U përmend një marrëveshje dhe më intereson të dijë a ka afat në atë marrëveshje se kur duhet të përfundojë ky proces, është mirë që ky problem të zgjidhet dhe të hiqet prej tavolinës.

Ajo tha se do të insistojë për një debat për këtë çështje dhe të nxjerrë rekomandime Kuvendi i Kosovës.

Arbërie Nagavci tha se ka bërë disa pyetje për kryeministrin, por nuk ka marrë përgjigjeje. Pyetjet kishin të bënin me atë se a i njeh vendimet e qeverive të mëparshme, si të vitit 2004 dhe 2009, vendimin e mëhershëm të kryeministrit Mustafa për shpronësim dhe sa ka arritur vlera

që nevojitet për shpronësim tash? Ajo tha se vendimi që është prezantuar flet për shumë konfuzitet. A mund të dihet se cilët janë ata persona që janë duke punuar në këtë ekip, a është publik raporti i kompanisë konsulente gjermane, si dhe raportet e tjera dhe kur mendoni se do të përfundojë ky studim për minierën e re dhe do të ketë një zgjidhje përfundimtare.

Lirije Kajtazi tha se e dimë që projektet kapitale nuk janë të lehta për t'u realizuar, por më kapitale se jeta e njerëzve nuk ka asgjë. Kjo zvarritje është e pafalshme dhe meqë ka të bëjë me pjesën e aspektit të zhvillimit ekonomik, është mirë të mbajmë një takim të përbashkët edhe me Komisionin për Zhvillim Ekonomik, në mënyrë që të shohim se si do të shkohet në Kuvend kjo llogaridhënie. Nga prilli ka pasur kohë me u përgatitur një raport i detajuar dhe të vihet me një përfundim, në atë mënyrë që kjo çështje të merr fund.

Kryetarja tha se kemi informata që kryetari i Obiliqit ka ndërprerë dhënien e lejeve për ndërtim për banorët e Hades, ndërsa banorët nuk kanë pasur mundësi me ndërtuar shtëpi të reja. Ajo shtroi pyetjen se a keni informata sa shtëpi janë ndërtuar prej pronarëve të cilët nuk janë të Hades, pra kanë manipuluar.

Valdrin Lluka tha se grupi teknik e ka për detyrë me i kontaktuar banorët e fshatit Hade. Shpronësimi parashihet të kushtojë rreth 60 milionë euro, buxheti nuk është paraparë në këtë aspekt. Banka botërore parasheh që çdo shpronësim duhet të bëhet me marrëveshje dhe duhet të shteren të gjitha mundësitë e negociatave me banorët dhe nuk bënë në asnjë mënyrë me e përdorur dhunën. Edhe mbasi është shpallur zonë me interes të veçantë, pas vitit 2013 atje kanë vazhduar ndërtimet, kemi krijuar një taks forcë që merret me ndalimin e ndërtimeve pa leje. Termocentrali parasheh një investim rreth 10 milionë euro që thirret fondi për komunitetin, që ju shërben të gjithë qytetarëve që janë për rreth termocentralit për të bërë projekte të ndryshme zhvillimore për të mirën e atyre banorëve qoftë në edukim, shëndetësi apo çfarëdo fushe tjetër. Në grupin teknik janë njerëzit me kompetent të fushës së energjisë kemi përfshirë institutin INKOS, Universitetin e Prishtinës atë të Mitrovicës, ish- drejtorët e KEK-ut para luftës, që të japin kontributin e tyre lidhur me këtë çështje. Raporti i kompanisë gjermane është finalizuar dhe procesin e ka KEK-u, aj mundet të jetë edhe publik, dhe propozimi dhe rekomandimi i kompanisë gjermane është që të shkohet me opsionin numër një, që është veriu pa Hade, por ky opsion është i papranueshëm për qytetarët, sepse Hadja mbetet si ishull, dhe thëngjilli në jug është me efikasitet, pra prodhon energji me më pak thëngjill. Për 40 vitet e ardhshme janë rezervat e sigurta dhe nuk ka kosto të shpronësimit.

Salih Grajçevci, përfaqësues i fshatit Hade, tha se nëse ndërtimi i minierës bëhet nga jugu, atëherë, dijeni se është interes i vetëm një njeriut të Kosovës, e as i Bankës Botërore, as i askujt tjetër.

Hilmi Jashari tha se situata me Haden është një lloj getoje dhe prej 2004 qeveria ka reflektuar në shkëlqen e të drejtave të njeriut të këtyre banorëve. Është momenti i fundit kur institucionet shtetërore të këtij vendi të marrin një vendim dhe së paku të afrojnë një siguri juridike për këta banorë, këta banorë e dinë më mirë se cila është perspektiva. Tha se mundësitë e Komisionit Parlamentar janë të kërkojë një raport përfundimtar nga qeveria e Kosovës se cili është opsioni dhe baza juridike në kushtetutë dhe ligj. Nëse ju konsideroni se mundeni me ndihmuar në këtë drejtim, bashkë me Institucionin e Avokatit të Popullit, me mendime konkrete, në mënyrë që në fund, kjo çështje të adresohet në Kryesinë e Kuvendit dhe në Kuvend, që të marrin një vendim të drejtë dhe përfundimtar.

Kryetarja tha se a ka mundësi me pasur raportin e Bankës Botërore, ndërsa i bëjë thirrje publike ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që ta vizitojë Haden për të parë gjendjen konkrete.

Saranda Bogujevci tha se nëse ftohet ministrja në komision është mirë me qenë edhe përfaqësuesit e komunës.

3. Njoftim i Komisionit FunkSIONAL lidhur me shqyrtimin e Peticioneve nga Grupi Punues

Kryetarja njoftoi komisionin se grupi punues për shqyrtimin e peticioneve, në takimin e mbajtur më 21 qershor 2018, ka shqyrtuar petitionin e ish- Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe kërkesën e Hasan Shalës për përjashtim nga vendi i punës.

Komisioni lidhur me këto kërkesa konstatoi se sa i përket petitionit të ish- Sindikatës së Policisë së Kosovës para se të ftohen në komision edhe një herë, paraprakisht nga MPMS të kërkohej një informatë se çka është ndërmarrë.

Ndërsa sa i përket kërkesës së Hasan Shalës për përjashtim nga vendi i punës, të kërkojmë dokumentacionin që ka dërguar në Gjykatë dhe të dihet se a ju ka adresuar kërkesa e tij Institucionit të Avokatit të Popullit dhe nëse ka raport nga Avokati i Popullit të na i dërgon edhe atë raport.

4. Të ndryshme

Kryetarja tha se ka qenë kërkesë e Avokatit të Popullit që të diskutojmë lidhur me mos zbatimin e rekomandimeve të IAP nga ana e Institucioneve të Republikës së Kosovës që kanë qenë të obliguara t'i zbatojnë.

Hilmi Jashari tha se kemi një neglizhencë të autoriteteve publike dhe kam dashur me tërhequr vëmendjen e Komisionit FunkSIONAL, për të adresua këtë çështje, do t'i përcjellë të gjitha rekomandimet veç e veç për secilin institucion të cilat kanë dështuar në zbatimin e tyre dhe shpjegimin e tyre. Mandej do të ishte e përshtatshme të ftohen institucionet publike në takim dhe të deklarohen para komisionit pse nuk po zbatohen rekomandimet. Ajo çka do duhej të këtë vëmendjen e juaj është një fenomen shumë negativ që ka prekur substancën e shoqërisë kosovare që është fjala për të rinjtë e vendit për drogën dhe bëhet fjalë për 85 raste të vdekjeve në vitin 2017 nga over doza. Nuk ka asnjë qendër në Kosovë që merret me rehabilitimin e të rinjve prej vartësisë së drogës dhe substancave tjera narkotike. Tha se kanë filluar me e hartuar një raport për këtë temë në mënyrë që të keni të dhëna dhe informacione të sakta dhe sa më të

plota për këtë dukuri, e cila pas vlerësimit të juaj në komision të shkojë në kryesi dhe Kuvend si temë për diskutim.

Lirije Kajtazi tha se kur është diskutuar në Kuvend për zbatimin e rekomandimeve të IAP ka rezultuar që secili komision me i ftuar ato institucione që i janë adresuar rekomandimet për të raportuar në komisionet e caktuara dhe me pa nëse është bërë progres, dhe besoj se të njëjtën gjë që e ka kërkuar Avokati i Popullit. Nga komisioni i ynë është mirë të bëhet ndonjë shkresë edhe në komisionet e tjera, sepse rekomandimet e Kuvendit i obligojnë, madje me i përfshirë edhe në planet e tyre të punës.

Teuta Haxhiu tha se mandatin e kaluar kam thirrur një debat parlamentar pse nuk zbatohen rekomandimet e Avokatit të Popullit nga qeveria, dhe një prej rekomandimeve është bashkëpunimi i komisioneve për rekomandimet e fushës dhe një tjetër është që raporti i Avokatit të Popullit mos të votohet dhe këtë kemi arritur me përfshirë edhe në draft-rregulloren e re të Kuvendit. Sa i përket sistemit të arsimit ajo tha se degradimi më i madh po i bëhet nga institucionet private.

Fisnik Ismajli pyeti si mundemi me u siguruar që ata fëmijë që janë në universitete po mësojnë diçka, cila është cilësia, ndërsa sa i përket përdorimit të drogës është shqetësuese numri i përdoruesve, po ashtu edhe konsumimi i alkoolit është problem te fëmijët.

Saranda Bogujevci tha se është shqetësuese se si është e mundur këta të rinj me pasur qasje të lehtë në çfarëdo lloj droge, dhe se mungojnë institucionet që merren me trajtimin dhe rehabilitimin e tyre.

Luljeta Veselaj-Gutaj: Këto çka u thanë këtu janë shqetësuese për secilin prej nesh, me intereson të dijë se a ka ndonjë hulumtim se ku është më i theksuar përdorimi i drogës në cilin regjion apo qytet, në mënyrë që aty të ketë edhe numër të shtuar të mekanizmave mbrojtës, dhe të sistemi i edukimit të rinjtë dhe të rejtat nuk janë të informuar për profesionet e caktuara dhe për gjendjen që i pret pas diplomimit karshi tregut të punës që e kemi ne aktualisht.

Hilmi Jashari tha se kemi disa raporte preliminare që i kemi të siguruar. por, në Kosovë, për gjendjen e drogës janë kryesisht 7 raporte deri më tani, nuk kemi një vlerësim se përdorimi ku është më i theksuar, problemi qëndron te mungesa e mekanizmave, politikave institucionale të preventivave, dhe mundemi me thënë se situata është jashtë çdo kontrolli. Sa i përket sistemit të arsimit së paku të rinjtë tanë ta kenë informatën, e atyre ju mbetet me vendosë sepse ne nuk mundemi me ua marrë të drejtën se çka duan ata me studiuar.

Shemsi Sylja tha se kjo që u diskutua është shumë shqetësuese dhe e rëndë, nga ky takim këtu do të ishte mirë që të ndërmarrim hapa konkret dhe të ndihmojmë.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se meqenëse jemi duke bërë vizita nëpër komuna është mirë me u takua me drejtorin e arsimit në komuna dhe me diskutuar se çfarë plani janë duke bërë nëpër komuna për eliminimin e dukurisë së drogës.

Kryetarja tha se për temën e drogës po presim raportin nga IAP dhe pastaj do të trajtojmë edhe në komision dhe nëse është e nevojshme edhe në Kuvend. Do të ftojme Ministrin e Arsimit, Shëndetësisë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Policinë e Kosovës.

Kryetarja njoftoi se Organizata Save the Children në Kosovë, do të organizojë një trajnim tri ditësh, lidhur me disiplinën pozitive, e që ka të bëjë me Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës. Trajnimi do të mbahet në Strugë të Maqedonisë nga 20-23 korrik 2018.

Saranda Bogujevci tha është thënë që të formojmë grupin punues për persona të pagjetur. Ajo u interesua të dije a po bëhet ky grup, t'i marrim të gjitha të dhënat të shohim ku janë gjërat dhe të bëjmë presion që EULEX me i futur gjërat, me ia dhënë qeverisë me u marr me to.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje